

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Fillim Skoro, kryetar, Vahid Halili dhe Abdullah Ahmeti, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, si procesmbajtës, në çështjen penale të akuzuarve D.K. e F.J., për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa e autorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope dhe analoge, në bashkëkryerje nga neni 273 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore-DKR në Gjilan, ankesës së mbrojtësit të akuzuarit F.J., av.Y.H., dhe përgjigjes në ankesë të mbrojtësit të akuzuarit D.K., av. R.A., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-DKR në Gjilan, PKR.nr.310/2016, të dt.27.12.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur në kuptim të nenit 390 par.1 dhe 4 të KPRK, me dt.20.03.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore-DKR në Gjilan, ankesa e mbrojtësit të akuzuarit F.J., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Gjilan, PKR.nr.310/2016, i dt.27.12.2016, VËRTETOHET.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore-DKR në Gjilan, PKR.nr.310/2016, të dt.27.12.2016, të akuzuarit D.K. dhe F.J., janë shpallë fajtor për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa e autorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope dhe analoge, në bashkëkryerje nga neni 273 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK dhe janë gjykuar i akuzuari D.K., me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1(një)viti dhe dënim me gjobë në shumë prej 500(pesëqind)Euro dhe F.J., me dënim me

burgim në kohëzgjatje prej 1(një)viti dhe me dënim me gjobë në shumë prej 500(pesëqind)Euro, të cilat dënime do të ekzekutohen në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse të akuzuarit nuk dëshirojnë ose nuk mund të paguajnë dënimin me gjobë, gjykata do të zëvendëson dënimin me gjobë në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20Euro, të dënimit me gjobë iu caktohet një ditë burgim.

Në dënimin e shqiptuar me burgim të akuzuarit D.K. dhe F.J., iu është llogaritur koha e kaluar në paraburgim prej dt.20.10.2016 deri me dt.27.12.2016.

Nga i akuzuari D.K., është konfiskuar narkotiku i llojit marihuanë në peshë prej 459.5gr.ndërsa nga i akuzuari F.J., është konfiskuar substanca narkotike e llojit marihuanë në peshë prej 508.8gr.

Të akuzuarit janë detyruar që të paguajnë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës dhe në emër të paushallit gjyqësor secili veç e veç nga 20Euro.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor, ankesë kanë paraqitur:

-Prokuroria Themelore-DKR në Gjilan, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarve t'iu shqiptohen dënime me burgim efektiv më të gjatë.

-Mbrojtësi i të akuzuarit F.J., av.Y.H., për shkak të vendimit mbi dënim, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet një dënim dukshëm më i butë.

-Përgjigje në ankesë ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuari D.K., av.R.A., me propozim që ankesa e prokurorisë të refuzohet si e pabazuar dhe aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Prokuroria e Apelit, me shkresën PPA/l.nr.78/2017, të dt.20.02.2017, ka propozuar që të aprovohet si e bazua ankesa e Prokurorisë Themelore-DKR në Gjilan ndërsa ankesa e mbrojtësit të akuzuarit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata në kuptim të nenit 390 par.1 dhe 4 të KPPK, mbajti seancën e kolegjit në të cilën ishin prezent të akuzuarit D.K. dhe F.J., mbrojtësi i të akuzuarit av.Y.H., ndërsa në seancë nuk prezantoi Prokurori i Apelit dhe mbrojtësi i të akuzuarit av.R.A., të cilët janë njoftuar me rregull për seancën e kolegjit, prandaj, gjykata nuk pati pengesa ligjore që të mbajë të njëjtën.

Mbrojtësi i të akuzuarit F.J., av.Y.H., sqaroi pretendimet ankimore dhe deklaroi se propozon si në propozimin në ankesë.

I akuzuari F.J., deklaroi se përkrah fjalët e mbrojtësit të tij.

Gjykata shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, ankesën e Prokurorisë Themelore-DKR në Gjilan, ankesën e mbrojtësit të akuzuarit F.J. dhe përgjigjen në ankesë të mbrojtësit të akuzuarit D.K. dhe gjeti se:

Ankesat janë të pabazuara.

Gjykata duke shqyrtuar aktgjykimin sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 394 par.1 të KPPK, gjen se aktgjykimi nuk është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare, gjatë shqyrtimit gjyqësor të akuzuarit kanë qenë prezent, gjatë shqyrtimit gjyqësor të akuzuarit kanë pasur mbrojtës dhe se nuk është shkelur ligji penal në dëm të akuzuarve.

Pretendimet për shkak të vendimit mbi dënim dhe gjetjet e gjykatës.

Prokuroria Themelore-DKR në Gjilan, në ankesë thekson se të akuzuarit kanë pranuar fajësinë, mirëpo, përkundër pranimin të fajësisë gjykata nuk iu ka shqiptuar të akuzuarve dënimin e merituar sipas ligjit, sepse këto dënime i ka zbutur deri në masë e cila bie në kundërshtim me rregullat e përgjithshme mbi matjen e dënimit, caktimin dhe zbutjen e dënimit.

Rrethanat lehtësuese çfarëdo qofshin ato assesi në rastin konkret nuk kanë guxuar të vlerësohen se janë të asaj rëndësie që do të ndikonin që dënimin e parashikuar ligjor për këtë vepër penale të zbutet deri në këtë nivel.

Si rrethana lehtësuese gjykata ka përmendur se të akuzuarit kanë pranuar fajësinë, janë penduar, kanë premtuar se në të ardhmen nuk do të kryejnë vepra penale, më parë nuk ishin të dënuar, ndaj të akuzuarve nuk udhëhiqet procedurë tjetër penale, për të cilat rrethana nuk ka dhënë kurrfarë arsye se do të arsyetonin dënimin e shqiptuar. Në rastin konkret nuk janë vlerësuar rrethanat rënduese, por gjykata vetëm ka theksuar mungesën e ndonjë rrethane rënduese.

Sikur gjykata të vlerësonte rrezikshmërinë shoqërore të kësaj vepre penale, sasinë e substancën narkotike, për afërsisht 1kg, që kanë pasur për qëllim ta shesin do të thotë se rrezikshmëria ka qenë e lartë, prandaj, gjykata është dashur ti shqiptoj një dënim me burg efektiv më të gjatë dhe dënim më të lartë me gjobë, do të ishte në proporcion me shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, duke pasur parasysh ato që u thanë më lartë prokuroria konsideron se me dënimet e tilla nuk do të arrihet të parandalohet kryerja e veprave penale me substanca narkotike që në regjionin e Gjilanit, janë në rritje e sipër.

Mbrojtësi i të akuzuarit F.J., av.Y.H., pretendon se meqenëse i akuzuari ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës, aktgjykimi i kundërshtuar nuk është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, sikur që nuk është shkelur ligji penal ndaj të akuzuarit, mbrojtja konsideron se dënimi i shqiptuar është i ashpër, duke marrë parasysh prezencën e një varg rrethanave lehtësuese.

Gjykata me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, ka marrë parasysh një numër të madhe nga rrethanat lehtësuese që shkojnë në favor të akuzuarit e në mungesë të rrethanave rënduese me shqiptimin e një dënimi kaq të ashpër konsideron se këtë nuk e arsyetojnë. Duke u mbështetur në faktin e pa kontestuar se i akuzuari për herë të parë ka ra në kundërshtim me ligjin që rrethanat personale dhe karakteri i të akuzuarit bënë që jo vetëm që është penduar për veprimin e tij, por ka shpreh keqardhje të thellë, i akuzuari tre muaj më parë është martuar dhe në vepër ka përfshirë edhe mikun e tij, të akuzuarin D.K., i akuzuari që nga fillimi i procedurës ka bashkëpunuar me organet e ndjekjes, i njëjti ka ra në depresion, ndërsa gjatë gjithë procedurës është deklaruar se merr përgjegjësinë për sigurimin e narkotikëve.

Arsyet e paraqitura më lartë mbrojtja konsideron se edhe me shqiptimin e dënimit më të butë, bile edhe me një dënim nën minimum për këtë vepër penale e në prezencë të rrethanave lehtësuese duke përfshirë edhe rrethanat posaçërisht lehtësuese mund të arrihet qëllimi i dënimit.

I akuzuari për herë të parë ka ra ndesh me ligjin, është i moshës relativisht të re, ka pranuar fajësinë, të cilat rrethana gjykata i ka marrë të natyrës posaçërisht lehtësuese e në mungesë të rrethanave rënduese ka pasur vend për një dënim më të ulët, përkatësisht nën minimumin e paraparë për këtë vepër penale, duke përfshirë edhe dënimin me gjobë.

Pretendimet e prokurorisë se dënimet e shqiptuara të akuzuarve janë të buta dhe pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit F.J., se dënimi i shqiptuar është i ashpër, janë të pabazuara.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e caktimit të dënimeve të akuzuarve iu i ka marrë parasysh rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, kështu të akuzuarve si rrethanë veçanërisht lehtësuese u ka marrë për bazë pranimin e fajësisë, pendimin e tyre, moshën e tyre të re, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejnë vepra të tjera penale, se më parë nuk kanë qenë të gjykuar, ndaj tyre nuk udhëhiqet procedurë tjetër për vepra tjera penale, sjelljen e tyre korrekte si dhe gjendjen e dobët ekonomike ndërsa nuk ka gjetur ndonjë rrethanë posaçërisht rënduese.

Rrethanat lehtësuese që i ka pasur parasysh gjykata e shkallës së parë të akuzuarve, me rastin e përcaktimit të dënimit të akuzuarve, i aprovon edhe kjo gjykatë.

Prokuroria në ankesë nuk thekson ndonjë rrethanë konkrete e cila kishte me ndikuar që të akuzuarve t'iu shqiptohen dënime më të rënda nga ato të shqiptuara nga gjykata e shkallës së parë.

Vetë prokuroria në ankesë thekson se të akuzuarit kanë pranuar fajësinë, e në anën tjetër thotë se çfarëdo qofshin rrethanat lehtësuese gjykata nuk ka guxuar të vlerësoj se janë të asaj rëndësie që të ndikonin që dënimet e parashikuara ligjore të zbuten në këtë nivel.

Këto pretendime të prokurorisë janë të pabazuara sepse në nenin 75 par.1 nën par.1.1,1.2,1.3 të KPPK, është paraparë se gjykata mund të shqiptoj dënimin nën kufijtë e paraparë me ligj apo mund të shqiptoj lloj më të butë të dënimit, kur ligji parasheh se dënimi kryesit mund ti zbutet apo ti zvogëlohet kur gjykata konstaton se ekzistojnë rrethana posaçërisht lehtësuese të cilat tregojnë se qëllimi i dënimit mund të arrihet edhe me shqiptimin e dënimit më të butë dhe në rastet kur kryesi pranon fajësinë ose ka marrëveshje për pranimin e fajësisë.

Pra në rastin konkret të akuzuarit D.K. dhe F.J., kanë pranuar fajësinë, kështu që gjykatës së shkallës së parë i janë plotësuar kushtet ligjore sipas nenit 75 par.1 nën par.1.3 të KPPK, që të akuzuarve t'iu zbut dënimet, meqenëse të akuzuarit kanë pranuar fajësinë.

Gjithashtu është i pabazuar pretendimi i prokurorisë se gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar rrezikshmërinë shoqërore të kësaj veprë, sasinë prej afërsisht 1kg narkotik, që kanë pasur për qëllim që ta shesin, e që veprat e kësaj natyre në regjionin e Gjilanit, janë në rritje e sipër, sepse rrezikshmëria shoqërore e veprës ka bërë që vepra si e tillë të parashihet me ligj, sasia rreth 1kg narkotik-marihuan, është ajo që është, por nuk është ndonjë sasi e madhe, ndërsa pretendimi se në regjionin e Gjilanit, veprat e kësaj natyre janë në rritje e sipër, është i pabazuar në ndonjë raport konkret, prandaj, meqenëse prokuroria në ankesë nuk thekson ndonjë rrethanë konkrete e cila kishte me ndikuar që të akuzuarve t'iu shqiptohen dënime më të rënda nga ato të shqiptuara nga gjykata e shkallës së parë, kjo gjykatë gjen se pretendimet e prokurorisë se dënimet e shqiptuara janë të buta, janë të pabazuara.

Mbrojtësi i të akuzuarit në ankesë nuk thekson ndonjë rrethanë konkrete e cila kishte me ndikuar që të akuzuarve t'iu shqiptohen dënime më të buta nga ato të shqiptuara nga gjykata e shkallës së parë. Rrethanat në të cilat thirret mbrojtësi i të akuzuarit se i akuzuari për herë të parë ka ra ndesh me ligjin, është i moshës së re, ka pranuar fajësinë, janë rrethana të cilat realisht dhe drejt janë vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë dhe pikërisht pranimit i fajësisë së të akuzuarit është marrë si rrethanë veçanërisht lehtësuese dhe të akuzuarit i është shqiptuar dënimi nën minimumin e paraparë ligjor, meqenëse mbrojtësi i të akuzuarit në ankesë nuk thekson ndonjë rrethanë konkrete e cila kishte me ndikuar që të akuzuarit të shqiptohet dënim edhe më i butë nga ai i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë, atëherë kjo gjykatë gjen se pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është i ashpër, është i pabazuar.

Sipas gjetjes së kësaj gjykate dënimet e shqiptuara të akuzuarve i përgjigjen shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale për të cilën janë shpallur fajtor të akuzuarit, si dhe shkallës së përgjegjësisë penale të akuzuarve, e sipas bindjes edhe të kësaj gjykate me dënimet e shqiptuara ndaj të akuzuarve D.K. dhe F.J., do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 41 të KPRK, e që është të parandaloj të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale, të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale dhe të ndikoj në ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Nga çka u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në bazë të nenit 401 të KPPK.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PAKR.nr.67/2017, të datës 20.03.2017

Procesmbajtësi,

Bujar Balaj

Anëtarët e kolegjit:

1.Vahid Halili

2.Abdullah Ahmeti

Kryetari i Kolegjit,

Fillim Skoro
